




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE
TË KOMPANISË RAJONALE TË UJËSJELLËSIT
HIDROREGJIONI JUGOR SH.A PRIZREN PËR VITIN 2020**

Prishtinë, qershor 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit

Shtojca II: Pasqyrat financiare vjetore të audituara

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkohet falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Artane Rizvanolli, Ministre e Ekonomisë

Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve

Zenel Zenelaj, Ud- Kryeshef Ekzekutiv

Ibrahim Bajraktari, Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit

Adresa: Rr. "Wesley Clark", 20000, Prizren - Kosove, Prizren, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit Hidroregjioni Jugor sh.a Prizren për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit Hidroregjioni Jugor sh.a Prizren (Kompania), të cilat përmbajnë pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2020, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin Baza për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare të bashkangjitura për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pozitës financiare të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit Hidroregjioni Jugor sh.a Prizren deri me 31 dhjetor 2020, performancës së saj, si dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2020, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion të Kualifikuar

- C1 Hidroregjioni kishte angazhuar një kompani të licencuar për rivlerësimin e pasurive dhe më datë 31 maj 2020 kishte pranuar raportin përfundimtar të rivlerësimit. Bazuar në përmbajtjen e këtij raporti dhe bazuar në llogaritjet tona nga analizimi dhe krahasimi i tij me regjistrin e pasurive, vlerat e prezantuara në PFV të pasurive, shpenzimet e shvlerësimit, rezerva e rivlerësimit janë të nënvlerësuara. Rrjedhimisht, edhe shpalosjet për zërin e pasurive dhe rezervave nuk prezantojnë gjendjen e saktë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'.

Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike, Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Kompanisë Rajonale të Ujësjiellit Hidroregjioni Jugor sh.a Prizren me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion, transaksionet e kryera të Kompanisë Rajonale të Ujësjiellit Hidroregjioni Jugor sh.a Prizren kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Të hyrat nga subvencionet dhe të hyrat nga grantet ishin të nënvlerësuar për 50,679€, për shkak se kompania kishte aplikuar TVSh-në, edhe përkundër faktit që këto ishin të ardhura të liruara nga TVSH, sipas ligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike, Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Çështje tjetër

- 1 Për shkak të situatës së krijuar me Covid-19, kompania ka qenë përfituese sipas masës 4 të pakos për rimëkëmbje ekonomike të financuar nga Qeveria e Kosovës në shumë 400,000€. Këto mjete ishin destinuar për mbulimin e shpenzimeve operative në shumë 333,091€ si dhe shpenzimet e pagave në shumë 37,280€.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim

Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë Rajonale të Ujësjetës Hidroregjioni Jugor sh.a Prizren.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Kompanisë Rajonale të Ujësjetës Hidroregjioni Jugor sh.a Prizren është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Kompanisë Rajonale të Ujësjetës Hidroregjioni Jugor sh.a Prizren në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, si dhe të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.²

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrim një raport të auditimit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është niveli i lartë sigurie, por nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keqdeklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsye pritet që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre Pasqyrave Financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a, Prizren me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Si pjesë e auditimit, në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-t, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimit material të Pasqyrave Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit konform atyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për keqdeklarimin që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulimin, falsifikimin, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitet të kontrollit të brendshëm të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit Hidroregjioni Jugor sh.a Prizren.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim nëse baza e vijimësisë së kontabilitetit është e përshtatshme për përdorim nga menaxhmenti, bazuar në provat e siguruara të auditimit, nëse ekziston pasiguria materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit Hidroregjioni Jugor sh.a Prizren, për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet përkatëse në Pasqyrat Financiare ose, nëse zbulimet e tilla janë të papërshtatshme ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të bëjnë që NP-ja të pushojë së vazhduari sipas parimit të vijimësisë.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare, përfshirë edhe shpalosjet, për t'u siguruar se Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike³



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja C1 - Prezantim jo i saktë i pasurive në pasqyrën e pozitës financiare

Gjetja

Sipas SNK 16 - Pasuritë e paluajtshme, pas njohjes si një aktiv, një zë i aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) vlera e drejtë e të cilëve matet me besueshmëri do të bartet me shumën e rivlerësuar, që është vlera e drejtë e zërave në datën e rivlerësimit minus ndonjë amortizim i mëpasshëm i akumuluar dhe ndonjë humbje e akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël (neto) e një aktivi rritet si rezultat i një rivlerësimi, rritja kreditohet drejtpërdrejt tek kapitalet e veta me titullin mbivlerë (tepricë) rivlerësimi. Megjithatë, rritja njihet në fitim ose humbje për aq sa kjo mbulon uljen e rivlerësimit të të njëjtit aktiv të njohur më parë në fitim ose humbje, si dhe pika 50, shuma e amortizueshme e një aktivi do të shpërndahet mbi baza sistematike gjatë jetës së tij të dobishme. Ndërsa në pikën 55 të këtij standardi, jepen shpjegime se amortizimi fillon kur aktivi është i disponueshëm për përdorim, d.m.th. kur ai është në vendin dhe kushtet e nevojshme për të, që të ketë mundësi të funksionojë në mënyrën e synuar nga menaxhmenti.

Hidroregjioni kishte angazhuar një kompani vlerësuese për rivlerësimin e pasurive dhe më datë 31 maj 2020 kishte pranuar raportin përfundimtar të rivlerësimit. Bazuar në përmbajtjen e këtij raporti dhe bazuar në llogaritjet tona nga analizimi dhe krahasimi i tij me regjistrin e pasurive dhe vlerat e prezantuara në PFV, janë identifikuar çështjet si në vijim:

- Pasuritë pas rivlerësimit nuk ishin trajtuar sipas kërkesës së SNK 16. Si rrjedhojë e kësaj, vlera neto e pasurive afatgjata me 31 dhjetor 2020 ishte nënvlerësuar për 504,057€ (në PFV ishte paraqitur vlera 26,777,286€, ndërsa sipas auditimit do të duhej të ishte 27,281,343€);
- Rezerva e rivlerësimit në pasqyrën e pozicionit financiar dhe në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet me 31 dhjetor 2020 ishte 5,317,365€ (si rezultat i rivlerësimit të pasurive), ndërsa sipas përlllogaritjeve të auditorit kjo vlerë do të duhej të ishte 6,053,202€ duke i nënvlerësuar për 735,837€. Gjithashtu, rezervat tjera në vlerë prej 14,574,432€ janë rezultat i rivlerësimit të vitit 2007. Kjo për shkak se, kompania zhvlerësimin e përlllogaritur pas rivlerësimit të vitit 2007 e kishte njohur si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave pa zvogëluar rezervën e rivlerësimit bazuar në jetën e mbetur të përdorimit. Megjithatë, pjesa e mbivlerës është dashur të amortizohej veçmas dhe të zvogëlonte gradualisht rezervën përgjatë viteve të mbetura të përdorimit.
- Shpenzimet e zhvlerësimit të prezantuara në PFV nuk i kishte përlllogaritur duke u bazuar në jetëgjatësinë para rivlerësimit pra në vlerën historike të pasurive për periudhën para rivlerësimit, por duke marrë për bazë jetëgjatësinë sipas raportit të rivlerësimit dhe duke e kalkuluar për tërë vitin. Gjithashtu, për shpenzimet e zhvlerësimit për pjesën e pasurive të rivlerësuar është aplikuar jetëgjatësia pas rivlerësimit duke e zbritur rezervën në fund të vitit. Kalkulimet ishin bërë duke supozuar se rivlerësimi jep vlerën e pasurive me datë 01 janar 2020 dhe si rrjedhojë shpenzimet e zhvlerësimit janë nënvlerësuar për 231,781€ (sipas PFV-ve 809,336€ dhe sipas kalkulimeve të auditorit 1,041,117€).

Kjo ka ndodhur pasi që kompania nuk kishte aplikuar vlerën e përcaktuar nga kompania vlerësuese e pasurive e cila në raportin e rivlerësimit ka dhënë vlerën e drejte të pasurive më datën 31 maj 2020, të njëjtën e kishte aplikuar në salldon fillestare të vitit 2020 për tërë vitin aktual.

Ndikimi

Nënvlerësimi i vlerës së pasurive, shpenzimeve të zhvlerësimit dhe rezervës së rivlerësuar, ndikon në prezantimin jo të saktë në pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse dhe pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet. Për më tepër, i njëjti efekt i nënvlerësimit të këtyre zërave ishte prezantuar edhe në shënimet shpjeguese të shpalosjeve.

Rekomandimi C1

Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që të bëhen korigjimet e nevojshme të gabimeve të cilat kanë ndodhur me rastin e trajtimit të pasurive pas rivlerësimit të tyre, në mënyrë që vlera e pasurive të jetë e prezantuar saktë në pasqyrat financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Nënvlërësimi i të hyrave nga grantet dhe subvencionet

Gjetja

Sipas SNK 20 - 'Grantet qeveritare' grantet e marra për aktive të amortizueshme njihen si të ardhura gjatë periudhave në të cilat ngarkohet amortizimi për ato mjete. Më tej, sipas Ligjit Nr.06/L-105 për tatimin në të ardhurat e korporatave neni 8, të ardhurat e liruara pika 1.7, të ardhurat e përfituara nga grantet, subvencionet dhe donacionet, duhet të jenë në harmoni me rregullat dhe kushtet e përfitimit.

Në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, në kuadër të zërit. Të ardhurat tjera në vlerë 1,134,739€, ndër të tjera janë prezantuar edhe zërat "Të hyrat e shtyra nga grantet" në vlerë 280,883€ dhe "Të hyrat nga subvencionet" në vlerë 370,370€.

Të hyrat nga grantet, ishin prezantuar në vlerë 280,883€, shumë kjo e nënvlerësuar për 21,049€.

Të hyrat nga subvencionet janë pranuar në pjesën e parë të vitit 2020 në vlerë 400,000€, mirëpo kompania nuk kishte njohur subvencionet aq sa i kishte pranuar, por kishte prezantuar vlerën 370,370€, shumë kjo e nënvlerësuar për 29,630€.

Këto dy lloje të të hyrave bashkërisht janë të nënvlerësuara për 50,679€.

Nënvlërësimi i të hyrave nga grantet ka ndodhur pasi që kompania shpenzimet e zhvlerësimit për pjesën e parë të vitit 2020 kishte aplikuar jetëgjatësinë nga rivlerësimi i pasurive dhe jo jetëgjatësinë e pasurive për periudhën e para rivlerësimit, ndërsa nënvlerësimi i të hyrave nga subvencionet kishte ndodhur pasi që kompania vlerën të cilën e kishte pranuar ia kishte kalkuluar dhe zbritur vlerën e TVSH-së.

Ndikimi

Mos trajtimi adekuat në kontabilitet për të hyrat nga grantet dhe subvencionet ndikon në prezantim jo të drejtë të informatave në pasqyrën financiare.

Rekomandimi A1

Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që të merren veprime korigjuese për njohjen dhe regjistrimin e efekteve të rivlerësimit për të hyrat nga grantet dhe subvencionet në mënyrë që shuma e prezantuar në pasqyrën e të ardhurave të jetë e saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3 Gjetjet për çështjet e kontabilitetit dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Detyrimet afatshkurta

Vlera neto e zërit financiar të detyrimeve afatshkurtra e prezantuar në pasqyrën e pozitës financiare ishte 2,538,143€. Brenda këtij zëri janë prezantuar llogaritë e pagueshme tregtare dhe detyrimet tjera afatshkurtra. Ne kemi testuar 30 mostra për testim substancial në vlerë të përbashkët 2,433,464€. Hidroregjioni gjatë vitit 2018 ka qenë në kontrollë tatimore për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK). Kjo për shkak se Kompania pretendonte se ishte ngarkuar nga ATK me obligime të cilat nuk i takojnë. Kompania kishte parashtruar ankesë në departamentin e ankesave pranë ATK-së mirëpo ankesa ishte refuzuar. Me 20.09.2019 ishte ankuar tek Avokati i Tatimpaguesve i cili kishte kthyer rastin për ri kontrollë. ATK kishte kryer ri-kontrollën dhe me datën 18.03.2020 kishte konstatuar se kompania nuk kishte të drejtë në ankesën e parashtruar dhe se vazhdonte të kishte të njëjtat obligime. Kompania nuk ishte pajtuar me rezultatet e ri kontrollës dhe kishte hap rast kontestimor në gjykatë mirëpo për një pjesë të borxhit me datën 30.09.2020 kishte hyrë në marrëveshje me ATK-në. Si rrjedhojë e kësaj situatë, zërat dhe shumat që mund të afektohen nga kontesti gjyqësorë ne nuk i kemi komentuar në këtë raport.

Çështja C2 - Mos barazimi i evidencave kontabël dhe letër konfirmimeve për të pagueshmet

Gjetja

Sipas Kornizës Konceptuale për raportim financiar, paragrafi 4.26, një detyrim njihet në pasqyrën e pozicionit financiar kur ka gjasa që burime ekonomike të dalin nga njësia ekonomike për të shlyer një detyrim aktual dhe shuma me të cilën do të shlyhet detyrimi mund të matet me besueshmëri.

Llogaritë e pagueshme tregtare të prezantuara në Pasqyrën pozicionit financiar, nuk prezantojnë saktë gjendjen e tyre. Për të testuar saktësinë e llogarive të pagueshme tregtare, përveç procedurave tjera, ne kemi dërguar 30 letër konfirmime tek palët e treta/furnitorët me vlerë të përbashkët prej 2,448,649€. Deri në përfundim të auditimit kemi pranuar 20 letër konfirmime me vlerë të përbashkët prej 1,829,232€. Bazuar në analizat tona dhe letër konfirmimet e pranuar nga furnitorët, në (17) raste ekzistojnë mospërputhje në mes shënimeve kontabël dhe shënimeve të furnitorëve. Në (12) raste shuma e detyrimit ishte mbivlerësuar për 78,958€, ndërsa në pesë (5) të tjera detyrimi ishte nënvlerësuar për 17,959€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos harmonizimit të kartelave në mes të furnitorëve dhe kompanisë.

Ndikimi

Mungesa e kontrolleve adekuate në sistemin e kontabilitetit si dhe mos harmonizimi periodik i shënimeve kontabël të kompanisë dhe furnitorëve ndikon në prezantim jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare.

Rekomandimi C2

Bordi i Drejtorëve të sigurojë, krijimin mekanizmave adekuate që në periodha të rregullta kohore të bëhen harmonizimet me kartelat me secilin furnitorë në mënyrë që vlera e detyrimeve të prezantohet saktë në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjatë auditimit u identifikua një çështje që iu komunikua menaxhmentit dhe u zgjidh në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Kjo çështje nuk kërkon ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohet vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimit të ndërmarrë dhe rezultatit.

Çështja 1

Shpalosjet e PFV ishin me shënime shpjeguese jo të plota

Gjetja

- Kompania tek Detyrimet e tjera afatgjata, kishte prezantuar të hyrat e shtyra (grantet) në vlerë 13,566,544€, për të cilat në shënimet shpjeguese nuk kishte dhënë informacion të plotë në lidhje me politikat e zbatuara kontabël, natyrën dhe madhësinë e granteve, dhe nëse këto grante kanë kushte specifike që duhet të plotësohen;
- Një njësi ekonomike duhet të paraqesë shënimet shpjeguese në mënyrë sistematike, për sa kohë që kjo është e mundur. Kur përcakton një mënyrë organizimi, njësi ekonomike duhet të marrë në konsideratë efektin në kuptueshmërinë dhe krahasueshmërinë e pasqyrave të saj financiare. Njësi ekonomike duhet të referojë në mënyrë të kryqëzuar çdo zë në pasqyrën e pozicionit financiar, në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe në pasqyrën e rrjedhës së parasë, me informacionin përkatës në shënimet shpjeguese. Kompania nuk i kishte bërë emërtimet e njëjta si në pasqyrën e pozitës financiare me ato të shënimeve shpjeguese për: shënimin 3, 7, 12, 13, 14 dhe të shënimi 16 do të duhej të bëhej një klasifikim dhe informacion me i detajuar i shpenzimeve.

Veprimi i kërkuar

Bordi i Drejtorëve të sigurojë që shënimet shpjeguese, përmbajnë parimet bazë që përdoren për hartimin e PFV-ve dhe informacionet mbi përbërjen e zërave të pasqyrave janë dhënë sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit.

Për më tepër, të prezantohen si një dokument i vetëm me pesë pjesët e setit të pasqyrave financiare në kronologjinë e përcaktuar sipas udhëzimit të Udhëzimi Administrativ MF-Nr. 07/2019 për strukturën përmbajtjen dhe dorëzimin e raporteve financiare vjetore.

Rezultati

Kompania gjatë auditimit kishte bërë korrigjimet e kërkuara dhe kishte dhënë informacione shtesë në shënimet shpjeguese të PFV-ve.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2019 të Kompanisë kishte rezultuar në 11 rekomandime kryesore. Kompania kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, 6 rekomandime janë zbatuar, 4 ishin në proces dhe 1 rekomandim nuk është adresuar ende siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 1.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 1 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020


Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Çështjet për pasqyrat financiare	Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë që regjistrimet apo korrigjimet e transaksioneve financiare në librin kryesor të bëhen sipas planit kontabël duke prezantuar të dhënat të sakta të cilat janë në harmoni me shënimet kontabël. Për më tepër, të mos prezantohen shumat e dy zërave në pozicionin e vetëm një zëri në PFV.	Në PFV-të e vitit aktual janë prezantuar edhe fitimet e mbajtura.	I zbatuar
2.	Çështjet për pasqyrat financiare	Bordi i drejtorëve të sigurojë se Pasqyrat Financiare përmbajnë të dhëna të sakta edhe për periudhën paraprake në mënyrë që zërat financiar dhe shënimet plotësuese në mes të dy viteve të jenë të krahasueshme.	Shënimet e prezantuar në PFV-të e vitit 2020 janë të krahasueshme në mes të viteve.	I zbatuar
3.	Çështjet për pasqyrat financiare	Bordi i drejtorëve të sigurojë se janë bërë korrigjimet e gabimeve të identifikuara të cilat kanë ndikim tek pasqyra e ndryshimeve në ekuitet, për të prezantuar një pamje të drejtë dhe të vërtetë të kësaj pasqyre.	Gjatë auditimit janë identifikuar çështje tek pasqyra e ndryshimeve në ekuitet.	Pjesërisht i zbatuar

4.	Çështjet për pasqyrat financiare	Bordi i drejtorëve të sigurojë se janë bërë korrigjimet e gabimeve të cilat kanë ndikim tek pasqyra e rrjedhës së parasë, për të siguruar një pamje të drejtë dhe të vërtetë të lëvizjes së parasë nga secili aktivitet.	Gjatë auditimit janë identifikuar çështje tek pasqyra e rrjedhës së parasë.	Pjesërisht i zbatuar
5.	Çështjet për pasqyrat financiare	Bordi i drejtorëve të sigurojë që shënimet shpjeguese, përmbajnë parimet bazë që përdoren për hartimin e pasqyrave financiare dhe informacionet mbi përbërjen e zërave të pasqyrave janë dhënë sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit.	Nuk janë identifikuar çështje të njëjta.	I zbatuar
6.	Llogaritë e arkëtueshme	Bordi i drejtorëve duhet të sigurohet që të bëhet identifikimi i klientëve të cilët kanë paguar në llogaritë bankare të kompanisë, për t'i zbritur borxhet e tyre për shumat e paguara, në mënyrë që llogaritë e arkëtueshme të paraqesin një gjendje reale. Për më tepër, bordi duhet të sigurohet se janë vendosur mekanizma adekuat të kontrolleve të cilat ndihmojnë në identifikimin e klientëve me kohë dhe rrjedhimisht të evitohet krijimi i llogarive të pa identifikuara.	Nuk janë identifikuar çështje të njëjta.	I zbatuar
7.	Llogaritë e arkëtueshme	Bordi i drejtorëve të sigurojë që regjistrimet e veprimeve që japin efekt në disa periudha kontabël, të bëhen duke u bazuar në parimin akrual, respektivisht paratë e pranuar në avancë të njihen si detyrime ndaj klientëve, përkatësisht të hyra të shtyra dhe vetëm pasi të jetë kryer shërbimi të njihen si të hyra të periudhës.	Në PFV-të e vitit 2020 janë prezantuar pagesat në avansë nga konsumatorët.	I zbatuar
8.	Pasuritë afatgjata	Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme që të regjistrohen shumat e rivlerësimit të pasurive në regjistrat kontabël dhe të prezantohen në pasqyrat financiare vjetore në përputhje me SNK 16.	Rivlerësimi i pasurive është finalizuar gjatë vitit 2020 dhe është integruar në softverin e kontabilitetit, mirëpo kalkulimet e zhvlerësimit, rezervës së rivlerësimit dhe vlerës neto të pasurive në fund të vitit nuk ishin të saktë.	Pjesërisht i zbatuar

9.	Pasuritë afatgjata	Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme që në një periudhë sa më të shkurtë të bëhen të gjitha regjistrimet e nevojshme të përlogaritjes së zhvlerësimit të pasurive në përputhje me kërkesat e standardeve të kontabilitetit	Rivlerësimi i pasurive është finalizuar gjatë vitit 2020 dhe është integruar në softverin e kontabilitetit, mirëpo kalkulimet e zhvlerësimit, rezervës së rivlerësimit dhe vlerës neto të pasurive në fund të vitit nuk ishin të duhurat.	Nuk është adresuar
10.	Detyrimet afatshkurta	Bordi i drejtorëve të sigurojë, që vlera e detyrimeve prezantohet saktë në PFV si dhe të marrë masat e nevojshme korrigjuese të gabimeve në lidhje me detyrimet në të dhënat kontabël.	Kompania nuk kishte arritur plotësisht ta përmbush rekomandimin.	Pjesërisht i zbatuar
11.	Shpenzimet operative	Bordi i Drejtorëve duhet të marrë masa për të siguruar se paraja e imët përdoret vetëm për raste të paparashikuara dhe jo për blerjet të cilat mund të bëhen përmes procedurave të prokurimit.	Gjatë testimeve tona në kategorinë e mallra dhe shërbime nuk kemi hasur blerje të mallrave apo shërbimeve me para të imët.	I zbatuar

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që të bëhen korrigjimet e nevojshme të gabimeve të cilat kanë ndodhur me rastin e trajtimit të pasurive pas rivlerësimit të tyre, në mënyrë që vlera e pasurive të jetë e prezantuar saktë në pasqyrat financiare.
2.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që të merren veprime korrigjuese për njohjen dhe regjistrimin e efekteve të rivlerësimit për të hyrat nga grantet dhe subvencionet në mënyrë që shuma e prezantuar në pasqyrën e të ardhurave të jetë e saktë.
3.	Detyrimet afatshkurta	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, krijimin mekanizmave adekuate që në periudha të rregullta kohore të bëhen harmonizimet me kartelat me secilin furnitorë në mënyrë që vlera e detyrimeve të prezantohet saktë në PFV.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Arvita Zyferi, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Enver Boqolli, Udhëheqës i Auditimit



Liridona Berisha, Udhëheqëse e ekipit



Edon Kabashi, Anëtar i ekipit



Besim Lezi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit

Çështja	Komenti i NP-së	Pikëpamja e ZKA-së
Prezantim jo i saktë i pasurive në pasqyrën e pozitës financiare	<p>Duke u bazuar në pikën 1 Çështja C1, ne mendojmë që kemi vepruar drejtë, duke u bazuar në atë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Data e publikimit të tenderit ka qenë 29.10.2019 - Data e nënshkrimit të kontratës ka qenë 29.01.2020 - Lista e aseteve dhe vlera e aseteve në tenderë për të cilën është kërkuar të bëhet rivlerësimi ka qenë me datë 31.12.2019. <p>Operatori ekonomik i cili ka bërë vlerësimin e aseteve, ka patur këtë listë të aseteve.</p> <p>Data e dorëzimit të raportit të vlerësimit të aseteve 31.05.2020 ka rezultuar për shkak të gjendjes Pandemike Covid-19 që ka ekzistuar dhe ekziston ende.</p>	<p>Hidroregjioni ka përshkruar procesin dhe ka dhënë arsyetime. Por kompania vlerësuese e pasurive në raportin e rivlerësimit ka përcaktuar vlerën e drejte të pasurive të Hidroregjionit me datën 31.05.2020 dhe sipas SNK-ve nga kjo datë duhej të kalkulohej zhvlerësimi për vlerën dhe jetën e përdorimit të rivlerësuar, ndërsa para kësaj date duhej të behej me vlerat dhe jetën e përdorimit të pasurive para rivlerësimit.</p> <p>Ky veprim ka shkaktuar nënvlerësimin e pasurive. E gjetura dhe rekomandimi i auditorit mbetet i njëjtë.</p>

<p>Nënvlerësimi i të hyrave nga grantet dhe subvencionet</p>	<p>Të hyrat nga grantet të prezantuara në shumë prej 280,883€, është rezultat i zhvlerësimit të asetëve nga donacionet dhe shuma prej 21,049€ si shumë e nënvlerësuar në tërësi është derivate dhe rezultat i çështjes C-1 dhe jo si e gjetur e re.</p> <p>Ndërsa subvencionet në vlerë prej 400,000€ për efekt të TVSH-së jemi bazuar në Ligji nr. 05/L-037 Për TVSH dhe Udhëzimin Administrativ MF-Nr. 03/2015 Për zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH në nenin 3 pika 2.6, 2.7, dhe 2.8.</p> <p>Me këtë Subvencionë ne kemi paguar shpenzimet operative (Faturat e operatorëve ekonomik). Për këtë ne mendojmë që kemi vepruar në përputhje me Ligjin.</p>	<p>Të hyrat nga grantet janë të prezantuara në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe si zë është i ndarë dhe trajtohet si i veçantë.</p> <p>Ndërsa komentim për subvencione kompania e ka trajtuar nga pikëpamja e shpenzimit e jo nga pikëpamja e të hyrës që është trajtuar në gjetje, ky subvencion nuk është pranuar nga ndonjë biznes që është i regjistruar dhe deklarues i TVSH-së për t'i zbritur atë vlerë, por nga institucionet shtetërore që nuk janë të regjistruara dhe nuk deklarojnë TVSH, dhe si rezultat i këtij veprimi kompania kishte nënvlerësuar të hyrën nga subvencioni të prezantuara në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Andaj e gjetura dhe rekomandimi i auditorit mbesin të njëjta.</p>
--	---	---



KRU Hidroregjioni Jugor sh.a.

Adresa: Wesley Clark p.n., 20000 Prizren - Tel.: 029/ 2441150
e-mail: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e Pasqyrave Financiare të KRU Hidroregjioni Jugor sh.a për vitin 2020 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit, përveç çështjes C1 dhe A1; dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Zenel Zenelaj.....

Ud. Kryeshf Ekzekutiv,

Data: 17 qershor 2021, Prizren,



Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante.
- ² Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ³ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

K. R. U. " HIDROREGJIONI JUGOR " SH.A.

Pasqyra e pozitës financiare

më 31 dhjetor 2020

	Shëni	2020 €	2019 €
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3	414,080	670,003
Investimet financiare afatshkurtra		-	-
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	4	5,334,539	5,312,767
Stoqet	5	617,408	658,026
Pasuritë e tjera afatshkurtra	6	9,552	336,964
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		6,375,578	6,977,760
Pasuritë afatgjata			
Investimet financiare afatgjata - objekte ndertimore	7	2,893,934	1,849,705
Prona, pajisjet dhe impiantet	7	1,357,834	398,400
Prona investuese -tokat	7	2,956,300	1,585,150
Investimet në vijim	7	6,080,541	5,897,786
Pasuritë e paprekshme	7	98,945	113,080
Pasuritë e shtyra tatimore		-	-
Pasuritë e tjera afatgjata	7	13,389,733	9,395,682
Gjithsej pasuritë afatgjata		26,777,286	19,239,803
Gjithsej pasuritë		33,152,864	26,217,563
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Mbitërheqja bankare		-	-
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	8	2,464,880	2,254,890
Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër	9	18,760	35,489
Detyrimet e tjera afatshkurtra (detyri. ndaj kons.ne parapagim)	10	54,503	43,148
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		2,538,143	2,333,527
Detyrimet afatgjata			
Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë	11	8,186	8,186
Detyrimet e shtyra tatimore	12	1,732,380	2,127,000
Detyrimet e tjera afatgjata	13	13,566,544	11,535,788
Gjithsej detyrimet afatgjata		15,307,110	13,670,974
Gjithsej detyrimet		17,845,253	16,004,501
EKUITETI			
Kapitali aksionar	16	25,000	25,000
Fitimet - humbjet e mbajtura	16	(4,663,966)	(4,400,780)
Fitimi - humbja e vitit	16	54,779	14,410
Rezervat e tjera	16	14,574,432	14,574,432
Rivlersimi l aseteve		5,317,365	
Gjithsej ekuiteti		15,307,611	10,213,062
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		33,152,864	26,217,563

Drejtori i përgjithshëm/ekzekutiv

Drejtori Financiar (ZKF)

Kontabilisti i Certifikuar

Zenel Zenelaj

Ibrahim Bajraktari

